MBRETNIJA SHQIPTARE

MINISTRIJA E EKONOMIS KOMBËTARE

Ligjë

mbi

Banken Bujqësore të Shqipnis

Tiranë 1936
Shtypshkroja «Nikaj»

BKSH

BKSH

Ligjë

mbi

Banken Bujqësore te Shqipnis

I. Karakteri, Qellim dhe Qendra e Bankës

Neni 1.

Banka Bujqësore e Shqipnís, asht nji Institut publik dhe autonom krediti dhe formon personin juridik.

Qendra e Bankës asht në Tiranë. Banka ka të drejtë të hapi dega dhe axhensina kudo mbrenda Shqipnís.

Degat dhe agjencít krijohen ose suprimohen me vendim të Këshillit Administrativ të Bankës.

Neni 2.

Qellimi i Bankës Bujqësore të Shqipnís, asht me ndihmue personat fizik dhe juridik me anë kre-

diti e masave të tjera për zhvillimin e bujqësis në gjith degat e saja, si dhe me ndërmjetsín për krijimin dhe mbajtjen e organizatave dhe industrinave bujqësore.

II. Kapitali dhe Rezerva e Bankës

Neni 3.

Kapitali i Bankës Bujqësore perbahet prej:

a) Çmimit të tokave të çpronsueme në favor të bujqëve proletarë i cili do të derdhet prej tyne si mbas nenit 45 të Ligjës mbi Reformen Agrare.

b) Të mbetunavet nga kreditet e Bankës Bujqësore Ottomane që janë nxjerrë deri në daten e hymjes në fuqí të ligjës mbi të mbrapambetunat me datë 21 Nanduer 1933.

c) Ndaljes së nji rroge të nëpunsave civilë e ushtarakë, tue u perfshî edhe shpërblimet e Deputetëvet, të Ministrave e tjerë që janë derdhë prej tyne n' Arkën e Shtetit, me rastin e hymjes në fuqi të Ligjës mbi Reformen Agrare.

ç) Taksave mbi kilogram alkool anhydre si mbas ligjës së posaçme.

d) Çmimeve të shitjes së pasunive Shtetnore si mullí, han, ullishta, kullota, ndërtesa ose toka të shpërndame dhe pasuní të tjera patrimonjale të

panevojshme dhe kurdoherë që këto jetersohen si mbas ligjave autorizuese të posaçme.

dh) 10% (dhet për qind) të mbi-taksës konsumi mbi kafen e përmendun në Nenin 72 të Tarifës Doganore me gjith ndarjet e saj a; b; c; ç; d; e 5% (pesë për qind) mbi sheqerin, përmendun në ndarjet e saj a, b, c, ç, d, dh:

e) Fitimeve netto që rrjedhin prej operacioneve të saja në bazë të bilancit vjetuer si mbas nenit 79 të kësaj Ligje.

ë) Subvencjoneve që do t' i bajë eventualisht Financa e Shtetit Bankës Bujqësore.

f) Detyrimeve të nxjerruna prej bujqve që rrjedhin nga sendet që u janë akordue prej fondeve të rendëshme të Ministris s' Ekonomis Kombëtare në të holla ose në natyrë: vegla bujqësore e tjera.

g) T'ardhunave të vërtetueme nga qiranat e dyqaneve dhe të ndertesave si mbas parag. ë) dhe nga njifishi i patentës vjetore si mbas parag. f) të Ligjës mbi Formimin dhe Qellimin e Bankës Bujqësore Kombëtare me datë 3 Maj 1930.

Neni. 4.

Kryegjaja e Bankës Bujqësore asht e pa kufizueshme.

III. Drejtimi

A. Këshilli Administrativ i Bankës

Neni 5.

Banka Bujqësore e Shqipnís administrohet prej nji Këshilli, i cili përbahet prej Drejtorit të Përgjithshëm; me antarë:

2 (dy) delegat të Ministris s' Ekonomis Kombëtare, prej të cilëve njeni duhet të jetë Ingjenjer Agronom;

2 (dy) delegat të Ministris së Financavet, prej të cillve njeni duhet të jetë nëpunës epruer i Kontabilitetit;

2 (dy) delegat të sindikatave bujqësore dhe kooperativave bujqësore;

2 (dy) delegat t' aksionistave të Bankës.

Misioni i antarve të Këshillit vazhdon për katër vjet, dhe në perjudhën e parë në mbarim të dy vjetëvet, përtrihet gjysma, d. m. th. nga nji delegat i Ministrís s' Ekonomís Kombëtare, i Ministris së Financavet i Sindikatve e Kooperativave dhe i aksionistavet.

Antarët e zgjedhun, në mbarim të periudhës së tyne, janë të rizgjedhëshëm.

Këshilli, në gjinin e vet, zgjedh Kryetarin dhe Nënkryetarin e tij.

Deri sa të shenohen antarët e zgjedhëshem, Këshilli Administrativ vepron pa ata dhe vetem me antarët e emnuem *ex officio*.

Neni 6.

Mënyra e zgjedhjes e të dy delegatve prej Sindikatave dhe Kooperativave bujqësore ashtu edhe të dy delegatve t'aksionistave, do të caktohet me nji rregullore.

Neni 7.

Në rast se n'institutet Arsimore të Kryeqytetit do të krijohet ndonji kathedre e ekonomis politike ose e ekonomís bujqësore, profesori i këtij mësimi, *ex officio* duhet të jetë antar i Këshillit të Bankës Bujqësore.

Neni 8.

Antarëve të Këshillit, për çdo mbledhje u akordohet nga 10 (dhetë) fr. ari, por kurdoherë shuma komplesive nuk mund të kalojë të 30 (tridhetë) fr. ari në muej.

Neni 9.

Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Bujqësore pro-

pozohet prej Ministrit t'Ekonomís Kombëtare dhe me aprovim të Këshillit Ministruer emnohet me Dekret-Mbretnuer. Rroga e tij do të jetë analoge me rrogen e Drejtorave të Përgjithshëm të Shtetit.

Në rasë që Drejtori do të jetë nji specjalist i marrun me kontratë rroga e tij do të caktohet n'ate.

Neni 10.

Nuk mund të zgjidhen antarë të Këshillit Administrativ:

a) bankarët, sarafët ose uzurarët profesionista;

b) dy persona së bashku që janë ortakë midis tyne ose që ndodhen në gjini në shkallen e katert ose në krushqi deri në shkallen e dytë;

c) personat e falimentuem;

ç) personat e dënuem me delikte mashtrimi, keq-perdorim besimi, vjedhje, falsifikime ose të dënuem për shkak të veprave që nuk pajtohen me nderin tregtar;

d) personat që kanë nëpunsi me rrogë në sindikatat bujqësore ose në kooperativat e industrive bujqësore.

Shperblimet që merren për çdo mbledhje, si edhe përqindjet mbi fitimet nuk konsiderohen rroga.

Neni. 11.

Drejtori i Përgjithshëm, Kryetâri i Këshillit Administrativ, Nënkryetari i këtijţKëshilli, dhe antarët e tjerë do të betohen, si mbas Rregullores, pranë Kryeministrit; gjith nëpunësit e tjerë të Bankës, të degave dhe të azhensive do të betohen para Drejtorit të Përgjithshem. Për çdo betim mbahet nji proces verbal, që ruhet n' arshiven e Bankës dhe mbi të cilin mbahet shenim në jetëshkrimin e të betuemit.

Neni 12.

Këshilli Administrativ ftohet në mbledhje të plotë nga ana e Drejtorit të përgjithshëm dhe kuër çfaqet nevoja nga ana e Kryetarit ose Nenkryetarit të Këshillit të paktën nji herë në tre muej. Mledhjet e Këshillit janë të vlefshme kuër ndodhet pranë gjysma plus nji e anëtarvet dhe Këshilli vendos me shumicën e votave t' antarve prezent.

Kuër votat janë bâra sparavlén ana e Kryetarit.

Bisedimet e Këshillit janë të mëshefta.

Neni 13.

Drejtori i Përgjithshem nënshkruen akte n' êmnin e Bankës Bujqësore të Shqipnís.

Këshili Administrativ do të zgjedhi dhe nji përson tjetër prej gjinit të tij për me nënshkrue aktet bashkë me Drejtorin.

Në mungesë të Drejtorit nënshkruan nëpunsi mâ i naltë i Bankës i aprovuem prej Këshillit Administrativ.

Këshilli Administrativ mund t' autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm me nënshkrue vetmas aktet që nuk angazhojnë Bankën financjarisht dhe ata që nuk kanë nji karakter të përgjithshëm dhe të përhershëm.

Neni 14.

Këshilli Administrativ ká për detyrë :

a) me caktue konditat dhe kompetencën mbi veprimet bankare, sikundër edhe normat e krijimit të degave dhe të azhensive të ndryshme ;

b) me caktue përqindjen e kamatave të huanave të ndryshme që ka me u dhânë Banka përsonave fizikë ose moralë si edhe të depozitave ; kamatat e huanave vihen në zbatim me vendim të Këshillit Ministruer;

c) me caktue letrât me vleftë dhe mallnat që mund të pranojë Banka si pêng ;

ç) me caktue sasín maksimale të kredinave që

do t'u çeli Banka sindikatave Bujqësore, kooperativave t' industrive bujqësore kolektivisht ashtu edhe personave që merren me bujqësí individualisht;

d) me vendos lidhjen e paqësimeve gjyqësore ose jashta gjyqësore ndërmjet Bankës dhe debitorve të sajë;

dh) me vendos çeljen dhe mbylljen e degavet dhe t' agjensinavet të Bankës;

e) me pregatitë raportin dhe bilancin e përvitshëm të Bankës;

ë) me çfaq mendimin mbi gjith projekt-ligjët dhe rregullorët që u përkasin çeshtjeve të Bankës Bujqësore;

f) me pregatitë budgetin e Bankës si edhe kuadrot dhe rrogat përkatëse përsa i përket vetëm shpenzimeve t'administratës i cilli duhet t' aprovohet prej Ministrís s'Ekonomís Kombëtare;

g) me hartue rregulloren e mbrendëshme për ekzekutimin dhe justifikimin e shpenzimeve si mbas budgetit, e cila aprovohet nga Ministrija e Ekonomís Kombëtare në marrëveshje me Ministrín e Financavet.

B. Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm

Neni 15.

Drejtori, drejton veprimet e Bankës, vezhgon për me sigurue respektimin e ligjëve dhe të rregulloreve, përfaqëson Bankën para autoriteteve gjyqësore dhe administrative ashtu edhe para personave të tretë dhe fton Këshilin Administrativ kuër e shef të nevojshëm.

Banka Bujqësore mund të përfaqësohet edhe prej përsonave të tjerë të ngarkuem prej Drejtorit ose prej zevendësit të tij me përfaqësí të posaçme.

Neni 16.

Formohet nën kryesín e Drejtorit të Përgjithshëm, nji Komitet ekzekutiv, i përbamun prej dy antarve të Këshillit Administrativ, të zgjedhun prej këtij në gjinin e vet.

Këshilli Administrativ ka tagër me i delegue komitetit ekzekutiv disa nga kompetenca e tija.

C. Nëpunsat e tjerë të Bankës

Neni 17.

Emnimi dhe pushimi i gjith nëpunsave të Bankës, të degavet dhe të agjensinavet të sajë, bâhet prej

Drejtorit të Përgjithshëm, duke qenë i mbështetun mbi vendimin e Komitetit ekzekutiv, marrun në bazë të propozimit t' arsyeshem e të justifikuem prej Drejtorit përkatës, ose prej superjorit imediat të nëpunsit.

Neni 18.

Nëpunsat e Bankës Bujqësore duhet të kenë konditat e përgjithshme që cakton ligja e nëpunsave në vij të përgjithshme dhe konditat e posaçme që përmban rregullorja e kësaj ligje.

Gjith nëpunsat e Bankës Bujqësore konsiderohen si nëpunsa të Shtetit, gëzojnë të drejtat e privilegjet e atyne, dhe u shtrohen dispozitave të ligjës së pensioneve.

Neni 19.

Rrogat e nëpunsave të Bankës Bujqësore tregohen në nji kuadre që pregatitet prej Këshillit Administrativ dhe duhet t' aprovohet prej Ministrís s' Ekonomís Kombëtare.

Shpenzimet e udhëtimit, dietat ashtu dhe shpenzimet e tjera, si shkresina, qirá e tjera, të parapame në buxhet, caktohen prej Këshillit Administrativ.

Shpenzimet e jashtzakonshme të pa-parapáme në buxhet, mund të bahen në rasa kësodore me vendime t' arsyeshme e të justifikueme të Këshillit Administrativ të Bankës dhe duhet t' aprovohen prej Ministrís s' Ekonomís Kombëtare.

Ushtrimi i budgetit vjetuer të Bankës ashtu dhe fornizimet e saja për me dhânë kredí në natyrë, sindikatavet bujqësore kooperative industrore, dhe përgjithësisht atyne pronarve tokash që meritojnë kredín, bâhet në konformitet të nji rregullorëje të posaçme e adoptueme prej Këshillit Administrativ të Bankës dhe t' aprovueme prej Ministrís së Ekonomís Kombëtare.

Neni 20.

Sasija e garancís për nëpunsit e Bankës, të cilët, si mbas ligjës përkatëse, detyrohen me dhân garancí, caktohet prej Këshillit Administrativ, dhe nëpunsat, kuër largohen nga shërbimi, passi të merret në dorëzim llogarija, dokumentat dhe sendet përkatëse, lirohen nga garancija me urdhën të Drejtorit të Përgjithshëm.

Ç. Degat dhe Agjensinat

Neni 21.

Administrimi i degavet dhe i agjensinavet të Bankës Bujqësore u mbesohet nëpunsave dhe, nëpër qendra të rândësishme, kuër shtohen veprimet e Bankës, Drejtorëve, të cilët ligjërisht përfaqësojnë degat ose agjensinat që funksjonojnë ndër qarqe.

Degat dhe agjensinat e qarqevet, mund të përfaqësohen pranë autoritetevet te vendit përsonalisht prej kryezyrtarve ose prej nëpunsit subaltern të tyne, por në këtë rastin e dytë, duhet të lajmërojnë me shkresë autoritetet administrative e gjyqsore të vendit.

Neni 22.

Degat dhe Agjensinat e Bankës do të kontrollohen rregullisht prej revizorve të posaçëm, të cilët do të jenë së paku të diplomuem prej shkollave të mesme tregtare (baras me maturë) dhe mjaftësisht të praktikuem.

Numëri i revizorve ka me qenë, si mbas nevojës së sherbimit, si mbas zhvillimit të veprimeve e të sasís së degave.

Revizorët e përmendun në paragrafin e sipërm

në vazhdim të kontrollimit të tyne, do të mbajnë nji proces-verbal për ç' ka do të konstatojnë në veprimet e degave dhe t' agjensinavet: si, mos pagimi i detyrimeve, zbulimi i abuzimeve, konstatimi i dâmeve të tjera që ká pësue Banka, por të shkaktueme prej organeve të sajë.

Nji kontrollim të tillë mund t' a bâjë edhe Drejtori vetë ose nji nëpunës epruer i Bankës. Si revizorët ashtu edhe kontrollorët e tjerë, kuer mbajnë proces-verbal mbi çrregullime, detyrohen me kërkue spjegime me shkresë prej nëpunsavet që i janë shmângë detyrës.

Spjegimet e kërkueme duhet të paraqitën me shkresën mbrenda nji muaji pas marrjes së ftesës me shkrim dhe i përcillen Drejtorit të Përgjithshëm.

Proces verbali i revizorve formon provë deri sa t' atakohet përmbajtja dhe të provohet e kundërta. Drejtori i Përgjithëshëm, në mbështetje të këtij proces verbali, jep vendime për ndeshkime disiplinore ose për ndjekje penale kundra nëpunësit, kuër nga aktet rezultojnë shpërdorime. Kopja e Vendimit për ndjekje penale i komunikohet përsonit t' akuzuem dhe dorëzanësve të tij, të cilët mund t' a kundërshtojnë me shkrim mbrenda 15 ditëve.

Në ketë rasë gjith aktet dhe kundërshtimet i përcillen komitetit aksekutiv të Bankës, i cili mbrenda 14 ditëve duhet të japi vendimin definitiv ose për dergim në gjyqë të nëpunsit t' akuzuem ose për nji ndëshkim disiplinuer.

Në lutjen e kundërshtimit tregohen gjith provat dhe Drejtori i Përgjithshëm, para se t' i percjellë Gjykatës kundërshtimin, çfaq mendimin e tij mbi gjith çeshtjet që përmenden n' atë kundërshtim.

Gjykata, kuër e lypë nji nga palët, kërkon nji ekspert nga Financa ose nga Banka Kombëtare.

Revizorët nuk duhet të jenë, as ndermjet të tyne as me antarët e Këshillit Administrativ, as në gjini deri në shkallen e katertë as me krushqi deri në shkallen e dytë.

Dietat e revizorëve caktohen në budget.

Neni 23.

Kuër nga kontrollimet dhe hetimet Komiteti ekzekutiv konstaton nji çrregullim që nuk shkakton penalitet tjetër veç se shpërblimin e dameve të caktueme prej veprimeve të nëpunsit, aktet i referohen Këshillit Kontrollues për me gjykue llogarinat dhe me dënue nëpunsin me pagimin e të hollave që ka shkaktue humbien ose vendos çfajsimin

e tij. Vendimi i Këshillit Kontrollues asht i premë dhe ekzekutohet.

Por në qoftë se nga aktet e përmenduna rezulton se nëpunsi asht fajtor me qellim pervetim të hollash, me mitë, falsifikim, mashtrim ose të tjera faje që sjellin me vedi nji ndëshkim si mbas Kodit Penal, aktet i dorzohen Prokurorit të Gjykatës kompetente.

IV. Veprimet e Bankës

A. Mënyra e dhanjes së krediteve

Neni 24.

Kredinat akordohen në themel të rregullave t' adoptueme prej Këshillit Administrativ.

Neni 25.

Krediti që akordon Banka Bujqësore personave fizik ose juridik bahet në natyrë ose në të holla.

Neni 26.

Personave që nuk bajnë pjesë të sindikatave ose kooperativave bujqësore, mbi kërkesën e tyne me shkresë, Banka u akordon kredina, në natyrë ose në të holla, në bazë të nji raportit të dhanun

nga Komisjoni përkatës i kreditit në mënyrën si vijon :

a) Për kredinat që nuk kalojnë 100 fr. ari Komisjoni formohet prej Kryetarit të Komunes përkatse si kryetar dhe prej njenit prej antarve të Këshillit Komunal, të kryeplakut të katundit ku banon hua-kërkuësi dhe mësuesit të katundit (aty ku ka nji të tillë) ;

b) për kredinat mbi fr. ari 100 e deri në 500 fr. ari, Komisjonit të nalt-përmendun i shtohet dhe Agronomi ose Veterinari i qarkut, si mbas rastit, i cili merr kryesinë ;

c) për kredinat që kalojnë 500 fr. ari, në komisjonin e përmendun në paragrafin b) merr pjesë edhe i deleguemi i posaçëm i Bankës, si kryetar.

Në raportin e komisjonit duhet të shenohen hetimet e bame mbi vleftën e pasunís së lujtëshme dhe të pa-lujtëshme të hua-kërkuësit dhe konstatimin e qellimit për të cillin asht kërkue krediti.

Raporti në fjalë i paraqitet Drejtorís përkatse të Bankës.

Antarët e Komisjoneve të nalt-përmendun, janë solidarisht përgjegjës mbi përmbajtjen e raportës.

Neni 27

Nga krediti i posaçëm që Banka ka me çelun në favor të Sindikatave dhe Kooperativave bujqësore, këto, me garancín e tyne, do të mund t' u akordojnë antarve të vet huana deri në 100 fr. ari mbassi të jenë plotsue formalitetet e përshkrueme në paragrafin a) të nenit 26. Sa për kredina mâ të nalta se 100 fr. ari edhe për antarët e Sindikatave dhe të Kooperativave bujqësore do të veprohet si mbas paragrafeve b) e c) të nenit 26.

Kërkuësi i kreditit, kur âsht komiteti ekzekutiv i nji Sindikati bujqësuer, nevoja, lloji dhe sasija e kreditit, caktohen përshtat dispozitave të nenit 26.

B. Depozitat

Neni 28.

Banka Bujqësore mund të bajë veprimet e poshtëshënueme persa i përket depozitavet:

pranon depozita prej personavet fizik e juridik:

1) Me afat : *me ose pa kamatë.*

Depozitimet me afat nuk paguhen para skadimit t' afatit, përveç se në rasë të jashtzakonshme: kuër provohet nevoja dhe me lejen e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës. Leja e Drejtorit të Për-

gjithshëm, nuk kërkohet, kur bahet fjalë për çlirimin e depozitimeve të lana peng: për garanci për nëpunsí dhe për çeshtje gjyqësore. Lirimi në këto raste bahet me kërkimin e Zyravet përkatëse-

2) Pa afat: *me ose pa kamatë.*

3) Depozitime kursimore.

Depozitorët e mitun mund t'i terheqin depositat e tyne të kursyeme personalisht prej tyne, pa krye formalitetet e parapame prej dispozitave ligjore civile kuër llogarija e depozitës âsht çel përsonalísht prej të mitunvet.

C. Huanat

Neni 29.

Banka Bujqësore jep hua të sigurueme:

a) Me hipotekë;

b) me peng të gjâsë së gjallë, të mbjellunave, të veglave dhe maqinave bujqësore, të veglave të zêjtarivet dhe t'industrivet bujqësore, që figurojnë n'inventarin e firmës, dhe t'ardhunave të produkteve të pa punueme ose të punueme me dorë ose me maqina bujqësore ose të zêjtarëve, t'industrorve bujqësuer të depozitueme në magazinat e Bankës Bujqësore, në silloze, elevatorë ose në godina të tjera, ose të lanuna stif, ose të mbesueme për ruejtje huamarrësit vetë;

c) kundrejt kambjaleve me *avalues;*

ç) kundrejt skontave të nji portofoli të garantuem mirë dhe kundrejt varanteve të lëshueme nga magazinat e depozitave publike;

d) kundrejt pengut të letravet me vleftë, të emetueme ose të garantuem prej Shtetit;

dh) me llogarí rrjedhëse *(conte-courrant)* të garantueme në hipotekë, me letra me vleftë, me produkte bujqësore ose industrore bujqësore që nuk prishen shpejt, të depozitueme në depot publike ose në të tjera vende të shënueme prej Bankës.

Neni 30.

Banka Bujqësore jep hua me afate që caktohen nga Këshilli Administrativ në mbledhje të plotë.

Neni 31.

Banka Bujqësore jep hua:

I. — a) Mbi pjesën e pacenueshme dhe mbi pjesën e konditave të pronave ku âsht zbatue ligja e Reformës Agrare;

b) mbi pronat që përjashtohen nga zbatimi, si mbas Nenit 4, të Ligjës mbi Reformen Agrare;

c) mbi pronat ku nuk âsht zbatue ligja e Reformës Agrare.

II. — Banka jep hua gjer në 40 % (dyzet për qind) të vleftës së pronave të tregueme në pikën a) dhe b) dhe 20 % (njizet për qindë) të vleftës mesatare t' atyne të tregueme në piken c).

III. — Huatë me garanci hipotekore jepen me afat deri me 8 vjet.

IV. — Shuma që mund t'i api Banka nji huamarrësi, me garancí hipotekore, nuk mund të kalojë 20.000 (njizetmij) fr. ari gjithsejt.

Shuma e huas do t' i dorëzohet pronarit në këste që do të caktohen në kontratën e huas, tue marrë parasyshë zbatimin e planit të punimevet.

V. — Banka, huana me hipotekë do të mund t' akordojë deri me 25 % të kapitalit të sajë.

Neni 32.

Huatë që do të jepen nga ana e Bankës me garancí pengu të pasunís së lujtëshme si: gjâ e gjallë, të mbjelluna, vegla, maqina ose produkte nuk mund të kalojnë 60 % nga vlefta reale, si mbas çmimit të tregut të sendeve të pengueme.

Neni 33.

Banka, për huatë e akordueme me qellime bujqësore, mund të pranojë si peng edhe letra me vleftë.

Huatë këso doret nuk mund të kalojnë 50 % të çmimit që do të kenë këto letra në pjacë.

Neni 34.

Banka Bujqësore ep hua në mështetje të konëshementavet ose efekteve tregtare të lëshueme kundrejtë prodhimevet bujqësore të eksportueme prej produktorvet, sindikatavet ose kooperativave bujqësore, të cilave Banka do t'u ketë caktue nji kredí.

Ç. Kreditimi i Kooperativave dhe sindikatave bujqësore

Neni 35.

Banka Bujqësore, me vendim të Këshillit Administrativ të sajë, mund t'u caktojë nji kredí kooperativave bujqësore, jo vetëm për llogarín e atyne kooperativave por edhe me konditë që këto kooperativa të jenë ndërmjetës për me i akordue dhe sindikatavet bujqësore të katundevet ose privatëve bujqë, kredina, për me favorizue produktet bujqësore.

Në këtë rasë kooperativat do të veprojnë në bazë të normave të respektueshme prej Bankës vetë.

Neni 36.

Banka, veprimet e sajë, me sindikatat bujqësore të katundeve dhe me kooperativat bujqësore, i bân drejtë për së drejti me të holla ose duke garantue kredí.

Neni 37.

Sindikatat dhe kooperativat bujqësore, të cillavet Banka Bujqësore u ká caktue nji kredí, nuk mund të marrin hua prej përsonavet ose prej Institutevet Bankare të tjera, me kamatë mâ të naltë nga ajo që ká caktue Banka Bujqësore për veprimet e saja; gjith ashtu dy Institutet e sipërpërmenduna tepricat e tyne që kanë në të holla nuk mund t'i depozitojnë gjetkë për çfrytëzim.

Huat dhe kredinat të dhana sindikatave dhe kooperativave bujqësore prej përsonavet fizikë ose prej institutevet bankarë të tjera, kundra ndalimit që përmban paragrafi sipërm, paguhen vetëm passi të mbulohen plotësisht kredinat e Bankës Bujqësore.

Neni 38.

Banka Bujqësore kuërdoherë mund t' u presi kredín sindikatave dhe kooperativavet bujqësore që nuk u konformohen normave të përshkrueme

në nenet 35 e 36 të kësaj Ligje, me konditë që Banka Bujqësore t'i ketë lajmërue që mâ parë për këto çashtje.

Premja e kreditit nga ana e Bankës Bujqësore nuk ndalon këtë që të nxjerri çka i detyrohen kësaj.

D. Veprime të ndryshme

Neni 39.

Banka Bujqësore, e autorizueme me nji ligjë të posaçme, mund të kontraktojë huana, tue emetue obligasione, me ose pa garancín e Shtetit.

Neni 40.

Banka Bujqësore, kuer ka të holla mâ tepër se parashef që do t'i lypsen për veprimet e saja gjashtmujore, këto të holla, kundrejt nji kamate, mund të ja depozitojnë Bankës Kombëtare me afat ose pa afat, kamatë e cila formon nji element të kapitalit të Bankës.

Neni 41.

Banka Bujqësore, përveç ç'ka u tha mâ sipër, ká për detyrë, me drejtue, me u tregue udhë dhe me kontrollue me organet e sajë, veprimet e shoqënive kooperative t'industrive bujqësore, ashtu dhe

kooperativat e krijueme për me u dhanë kredí individuvet dhe institutevet bujqësore.

Neni 42.

Banka Bujqësore arkëton prej personave fizikë e juridikë që merren me bujqësí, çdo lloj efekte me vleftë të vendit ose të huaja dhe, kundrejt nji komisjoni t' arsyeshme pranon letra ashtu edhe sende me vleftë për me i ruejtë. Gjith ashtu Banka Bujqësore blenë vegla dhe materjale bujqësore, gjâ të gjallë, farë, plehna artificjale, materjale dhe produkte, specialitete të zêjtarve bujqësorë etj.

Neni 43.

Banka Bujqësore mund të ngrehë elevatorë, silloze, depora e të tjera për rregullimin e tregtís së drithnavet.

Neni 44.

Banka Bujqësore mund të blejë e të shesë malla ose pasuní të lujtëshme dhe të pa-lujtëshme vetëm për nevojat e saj, ashtu dhe kuër detyrohet të shesi n' ankant publik pasunít e debitorëvet në more.

Neni 45.

Banka Bujqësore mund të ndërmjetsojë për shit-blerje, midis eksportatorëve shqiptar ose të huej që blejnë produkte bujqësore dhe sindikatave që kanë depozitue drithë në magazinat ose në sillozat e Bankës. Gjith ashtu mund të ndihmojë kooperativat duke i u akordue kredina për krijimin e depove, t' installimeve dhe t' uzinave të nevojshme për qellimet e korporatës industrore bujqësore.

Neni 46.

Banka Bujqësore e Shqipnis asht e ndalueme të bajë veprime të tjera përveç atyne që janë caktue në këtë ligjë.

V. Drejtimi dhe kontrollimi i koorperativave dhe sindikatave të kreditueme prej Bankës

A Kontrollimi dhe procedura përkatëse

Neni 47.

Banka Bujqësore, me anën e organeve të kontrollimit ose t' organeve të tjerë të saj zyrtare të ngarkuem në format e duhuna, mund të kontro-

llojë, kuërdoherë që t' a gjejë të volitëshme dhe të nevojshme, gjith sindikatat bujqësore katundare ashtu dhe kooperativat bujqësore ose që sherbejnë për me eksportue mallnat bujqësore.

Organet e kontrollimit ose organet e tjerë të Bankës Bujqësore që bajnë detyrën e inspektimit ose të kontrollimit kanë po ato të drejta dhe privilegje të cilat gëzojnë Inspektorat e Financës nga pikpamja e autoritetit.

Organet e kontrollimit të Bankës Bujqësore, kuër konstatojnë mungesen e pagimit, shpërdorime ose dame dhe humbje të tjera që kanë pësue degat e Bankës, sindikatat dhe kooperativat, mbajnë nji proces-verbal dhe pastaj kërkojnë shpjegime me shkresë prej organeve pëgjegjëse të këtyne enteve.

Në këtë rasë, shpjegimet e lypuna duhet të paraqiten jo mâ vonë se nji javë nga data e marrjes së ftesës me shkrim.

Gjith këto akte së bashku me mendimin e organit të kontrollit i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës Bujqësore. Ky, personalisht ose me anë të nji të ngarkuemi, passi të ketë studjue aktet dhe shenimet e organit të kontrollit, si dhe spjegimet me shkresë të t' akuzuemit, dosarin ja

përcjellë Këshilltarit ligjor të Bankës, i cilli çfaq mendimin e tij rreth përgjegjësís së t' akuzuemit, dhe, në këtë rasë, veprohet si mbas Nenit 23 të kësaj ligje.

Këshilli Administrativ i Bankës, tue u mbështet në përfundimet e Këshilltarit ligjuer dhe në mendimin e çfaqun prej Drejtorit të Përgjithshëm, vendos :

a) Mbi përgjegjësin pekuniare të përsonit për të cilin jan bâ hetime; ose:

b) mbi përgjegjësin e fjeshtë penale; ose

c) mbi përgjegjësin penale dhe pekuniare së bashku.

Në rasën e përmendun në germen a) kopja e vendimit i komunikohet t' akuzuemit dhe garantavetë tij, të cilët kanë të drejtë kundershtimi mbrenda 15 ditëve nga data e komunikimit të kopjes së vendimit, pranë Këshillit Kontrollues, i cili në këtë rasë ushtron detyrat e gjykatores së llogarivet. Këshilli Kontrollues, passi ndigjon gojas spjegimet e t' akuzuemit, vendos definitivisht dhe në mënyrë të preme.

Në rasën e përmendun në germat b) dhe c) veprohet si mbas nenit 23 të kësaj ligje.

Me gjith këtë, përgjegjësija personale e organeve të kooperativave dhe të sindikatave nuk dispenson

përgjegjësin pekuniare dhe kolektive të kooperativave ose të sindikatave kundrejt Bankës.

Neni 48

I akuzuemi, parashtresen e kundërshtimit i a paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës dhe do të tregojë gjith provat e pretendimit të tij. Drejtori i Përgjithshëm, para se t' i përcjelli Këshillit Kontrollues parashtresën e kundërshtimit, detyrohet me bamë nji eksposé mbi shenimet e veta rreth gjith çeshtjeve të përmenduna në aktet.

Neni 49.

Në qoftë se shuma e abuzueme ose e konstatueme si mungesë, nga inspektimi, kapërcen sasin e garanciës që asht tregue prej nëpunsit dhe nxjerrja e plotë e kësaj shume rrezikohet, për me siguru të drejtën e Bankës ose të kooperativave bujqësore, të cilat në dhanje kredinash lejohen dhe ndihmohen prej Bankës Bujqësore, organet e kontrollimit mund të kërkojnë nga gjykata e qarkut nji sekuestro konservative mbi pasunit e debitorit. Nji sekuestrim i tillë mund të suprimohet vetëm me urdhënin e Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 50.

Kuër nga inspektimi i sindikatavet ose i kooperativavet bujqësore, merret vesht se punët e sindikatit ose të kooperativës nuk venë mirë, dhe se interesat e Bankës, të sindikatit ose t' antarve të kooperativës e të kreditorve të tjerë, rrezikohen për çdo shkak qoftë, Këshilli Administrativ i Bankës mund të vendosi nji kontroll mbi drejtimin e sindikatit ose të kooperativës, ashtu dhe mbi veprimet e tyne, dhe kuër e gjenë të nevojshme mund të kërkojë, prej Ministris s' Ekonomis Kombëtare, largimin e Komitetit eksekutiv të Sindikatit ose të Këshillit Administrativ të Kooperativës, ashtu edhe nji formim të rij që të mund të jetë në shkallë t'udhëheqi veprimet e sindikatit ose të kooperativës.

B. Funksionimi i Kooperativavet dhe i Sindikatavet Bujqësore të kreditueme

Neni 51.

Emnimi dhe pushimi i personavet që shërbejnë si drejtues dhe që kanë për mision mbajtjen e llogarivet (si Drejtor, Llogaritar, arkëtar) pranë kooperativave që gëzojnë kredín e Bankës Bujqësore, bahet me vendim të Këshillit Administrativ të Ko-

operativës i aprovuem prej Këshillit Administrativ të Bankës.

Në qoftë se Banka Bujqësore nuk i pëlqen përsonat e paraqitun prej Kooperativës, kjo detyrohet me paraqitë të tjerë, dhe në qoftë se Banka nuk i pëlqen edhe këta, kjo e fundit ka tagër t'i emnojë drejtë për së drejti.

Buxhetet e Kooperativës së kreditueme prej Bankës, duhet t' aprovohen prej kësaj. Sa për sin. dikatat bujqësore, në rasë që gëzojnë kredit prej Bankës, detyrohen me i paraqitë kësaj bilancin vjetuer të vërtetueme prej Agronomit të qarkut.

Neni 52.

Nëpunësit e Kooperativave të kreditueme prej Bankës Bujqësore, duhet të jenë persona që paguëjnë vergji të pasunive të palujtëshme të tyne dhe t' u shtrohen dispozitave të rregullores rreth kooperativave të hartueme prej Këshillit Administrativ të Bankës dhe t' aprovueme prej Ministris s' Ekonomís Kombëtare.

Neni 53.

Gjith Kooperativat e kreditueme prej Bankës Bujqësore detyrohen me i paraqitë kësaj garancinat e nëpunsavet të tyne, sasija dhe lloji i të ci-

llavet caktohet prej Këshillit Administrativ të Bankës.

Neni 54.

Kuër Banka konstaton se nëpunsat e ndonji kooperative tregojnë neglizhencë në kryemjen e detyrës ose abuzojnë autoritetin e tyne, ajo ka të drejtë të kërkojë pushimin dhe zavendësimin e këtyne nëpunsave.

Neni 55.

Jashta rasteve të parashikueme prej ligjës relative mbi kooperativat Banka mund të kërkojë nga gjykata e qarkut likuidimin e kooperativës:

a) Kuër me rastin e inspektimit konstatohet se kapitali i kooperativës âsht paksuem aq sá nuk mundet të realizojë vetë qellimet për të cilat âsht formue, dhe se afati gjashtë mujor që do t'u akordohet prej Bankës, Kooperativavet, për me thirrë mbledhjen e përgjithshme, me qellim që të vendosi shtimin e kapitalit të sajë ose shpërndamjen, nuk âsht realizue;

b) kuër Kooperativa bân veprime kundra qellimit të sajë;

c) kuër, me gjith që Kooperativa të mos ketë pushue pagesat, nga pasqyra e veprimeve dhe nga

llogarít e përvitshme të saja duket çiltazi se kredít bankare ndodhen në rrezik.

Në rast kësodoret, gjykata duhet të vendosi likuidimin e Kooperativës dhe t' emnojë likuidatorë, të cilët mund të merren nga rrethi i Këshillit Administrativ të Kooperativës.

Kuër emnohen likuidatorë, dhe likuidohen llogarinat, respektohen dispozitat e ligjës relative mbi Kooperativat, me konditë që njani nga likuidatorët duhet të jetë i êmnuem prej Bankës.

Kuër likuidimi i nji Kooperative, me përgjegjsí të pá kufizueme, âsht vendosë dhe deklarue prej gjyqit dhe në përfundim të likuidimit, rezulton se detyrimet kundrejtë Bankës nuk mund të paguhen plotësisht, likuidatorët mbledhin të mbetunat e të detyruemve nga anëtarët e Kooperativës, pá e deklarue këtë në faliment.

VI Norma dhe Privilegje të Posaçme

A Mbi sendet e lanuna peng

Neni 56.

Efekti i pengut, vuemun mbi pasunin e luejtëshme të huamarrësit, (përson fizik ose juridik) në

favor të Bankës bujqësore, fillon që prej datës së kontratës së lidhun midis tyne.

Neni 57.

Kredít e Bankës Bujqësore ose të Kooperativave mund t' u kundrejtohen përsonave të tretë me mirë - besim, që prej ditës së rregjistrimit të pengut në Bashki ose në Komune.

Neni 58.

Pranë Bashkive dhe Komuneve do mbahet nga nji libër i posaçëm ku do të rregjistrohen huat e lidhuna me garancí - pengu, ndërmjet Bankës Bujqësore ose Kooperative dhe hua - marrësavet.

Në këtë libër rregjistrohen: êmni i hua - marësit, shuma e huas, afati, sendet e pengueme dhe vendi ku ndodhen.

Neni 59.

Bashkít ose Komunet detyrohen me vërtetue ekzistencën e pengut mbi kërkimin e hua - marrësit ose të çdo përsonit të tretë.

Kryetarët e Bashkivet ose të Komunevet, kuër vërtetojnë, tue dijtë, se sendi që tregohet si objekt pengu prej hua - marrësit kundrejtë Bankës ndo-

dhet i liruem, kurse në realitet o sendi nuk eksiston aspak ose dhe n' eksiston ká qenë i penguem tanësisht ose pjesësisht, dhe ato e tregojnë si mâ sipër, gjithashtu sendet tue qenë të pengueme, japin leje për shitje, konsiderohen si bashkëvepruesit e hua - marrësit për mashtrim dhe dënohen deri në 3 (tre) vjetë burgim dhe janë solidarishtë përgjegjës me hua - marrësin për damet e pësueme prej Bankës.

Po me këtë ndeshkim dënohen edhe zyrtarët e Bashkís ose të Komunes që janë të ngarkuem me mbajtjen e librit të posaçëm, kuer nuk rregjistrojnë me kohë huanat e lidhuna kundrejtë pengut të sendeve të luejtëshme.

Passi rregjistrohet pengu, sendet e pengueme mbeten nën vezhgimin e autoritetit që e ká rregjistrue, i cilli, pá autorizimin e bankës, nuk mund të lejojë shitjen, transferimin dhe ndertimin e tyne.

Neni 60.

Gjaja e gjallë, të mjedhunat, veglat dhe maqinat bujqësore, produktet dhe gjith mallnat bujqësore veglat e punimit të lanuna peng Bankës Bujqësore ose Kooperativave, pá lêjen e tyne, nuk mund të lehen peng përsonave të tretë, as nuk mund të

sekuestrohen ose të shiten vullndetisht ose publikisht deri sá mos të paguhen plotësisht dhe tansisht shumat e marruna hua me kamatat dhe shpenzimet përkatëse.

Neni 61.

Banka Bujqësore, për me vue në dorë të drejtat e saja, ka tagër me i shitë vetë publikisht ose privatisht sendet e pengueme pa ndërhyrje gjyqsore.

Në qoftë se shuma e rëzultueme prej shitjes nuk mjafton me pague tanësisht kreditin e Bankës veprohet si mbas nenevet 71 e 72 të kësaj Ligje. Por në qoftë se çmimi i shitjes rezulton mâ tepër se krediti Bankës, teprica i këthehet hua - marrësit

Neni 62.

Debitori që jeterson, harxhon, ose mësheh tansisht ose pjesërisht pengun, dënohet deri me 3 (tre) vjet burgim.

Debitori, që tue ditë, në çastin e lidhjes së huas, msheh eksistencën e një sekuestroje që i âsht bâ ligjorisht mbi pasunít e luejtëshme që i' a ofron Bankës si peng, ose ekzistencen e nji grindjeje gjyqësore mbi to, dënohet deri me 3 (tre) vjetë burgim.

Në qoftë se debitori, që asht i ngarkuem me ruejtjen dhe me mbajtjen e pengut, nuk e përmush ketë detyrë, humbetë të drejtën me përfituem nga afati i huas, dhe Banka për me nxjerrë kreditin e sajë, vepron si mbas nenevet 71 e 72 të kësaj Ligje.

Neni 63.

Banka Bujqësore, me t' u pague huaja, pa vonesë lajmëron Bashkín ose Komunen për me shenue në librin e posaçëm shlirimin e pasunive të pengueme.

B. Mbi pasunít e hypotekueme

Neni 64.

Kuër debitori hypotekuer nuk kryen detyrimet e tija kundrejtë Bankës kjo nxjerrë n' ankant publik pasunít e hypotekueme. Në këtë rasë, në qoftë se debitori dhe Banka kuptohen në mes të tyne, pasunija nxjerret n' ankant duke u ndamë në parcela prej 5 deri në 40 hektarësh.

Banka Bujqësore, pasunít që i kanë mbetë nga mos realizimi i shitjes n' ankant, ká tagër me i ndamë këto pasuní në parcela prej 5 deri 40 hektarësh dhe me i shitë këto me ankant ose me marrëveshtje private.

Për shitjen e pronave të hypotekueme që i shtrohen shpronësimit si mbas Ligjës së Reformës Agrare, parcelimi dhe shitja e parcelave do të bâhet në bashkëkuptim midis Bankës dhe Drejtorís së Përgjithshme të Reformës Agrare.

Neni 65.

Banka Bujqësore, për pasunít e pá · luejtëshme të debitorve hypotekorë moroz që i kanë mbetun asajë, ká tagër, me Vendimin të Këshillit Administrativ, me u këthye pasunít debitorve, me konditë që këta mbrenda 5 (pesë) vjetëve dhe në formë amortizimi, të paguejnë detën, shpenzimet përkatse dhe kamatat. Mbi konditat e reja midis Bankës dhe hua marrësit, lidhet nji kontratë e ré.

Në qoftë se debitori, mbrenda 6 muejve qyshë prej datës në të cilen Banka ligjorisht hynë në posedimin e pasunís së hypotekueme, nuk i drejtehet Bankës për ri - blemjen e pasunís së tij, me konditat e sipërshenueme, ay humbetë të drejtën e ri-blemjes.

Kuër debitori, pasi të ketë lidhë kontratën me Bankën për riblemje me konditat e sipërshenueme nuk ndërron kontratat, Banka hynë rishtas në posedimin e pasunís, përveç kuer debitori, para se

të vendoset shitja e pasunís, me nji herë paguen kistet e kalueme dhe kamatet e rrjedhuna dhe justifikon me arësye të pëlqyeme mos-përmbushjen e kontratës.

Me vdekjen e debitorit, e drejta e ri-blemjes me konditat e sipër-sheueme, u shkon trashigimtarve legjitimë, si mbas dispozitave të Kodit Civil edhe me preferencen e poshtë-shënueme:

1) Të pas-lindunit;

2) të para-lindunit;

3) bashkëshortes;

4) gjinís në shkallën e dytë (vllazën, motër e pá martueme);

5) gjinís në shkallën e katërt.

Neni 66.

Në qoftë se trashigimtarët në shkallë të njijtë që gëzojnë të drejtën e ri-blemjes, çfaqin deshirën me ri-blemë mallin së bashku, detyrohen solidarisht për gjith borxhin.

Neni 67.

Debitori ká të drejtë me kërkue nga Banka që pasunija e shitun n'adjudikatë, të ri-blehet nga ana e gjinís së shenjueme në pikat 1-5 të Nenit 65.

Gjithashtu debitori ká të drejtë me kërkue riblemjen nga ana e përsonave të tretë që kanë qenë kufitár ose janë endè kufitár me pjesën e pasunís që i ká mbetë e lirë debitorit, kuër Banka e shef konformë me interesat e veta.

Debitorët e Bankës që janë shpërngulun nga Shqipnija e që janë instalue ndër vende të hueja, nuk mund të gëzojnë të drejtën e riblemjes në pasunít e shpronësueme prej sajë për borxhe.

C Privilegje të posaçme

Neni 68.

Vërtetesa dhe aktet e tjera që lëshojnë Institutet dhe Zyrat Shtetnore, Bashkijake dhe Komunale, ashtu dhe gjithë aktet e tjera të nevojshme për studimin dhe rregullimin e kreditit nga ana e Bankës Bujqësore, përjashtohen nga taksa e pullave.

Gjithashtu përjashtohen nga taksat përkatëse korespondencat postë-telegrafike si dhe mandatet postare të Bankës Bujqësore.

Pasunít e palujtëshme të Bankës, përjashtohen nga të gjithë kontributet Shtetnore direkte dhe indirekte ashtu dhe nga taksat Bashkijake, Komunale, e të çdo enti tjetër.

Përsoni juridik i Bankës, përjashtohet edhe nga tatim-fitimi.

Neni 69.

Gjithë aktet, dokumentat, produktet që dalin nga Banka Bujqësore si dhe nga degat e agjensinat e sajë, nuk vërtetohen prej Noterit.

Por kontrata mbi konstituimin e hipotekave bahen prej noterave tue u përjashtue vetëm nga taksat që i përkasin Shtetit.

Neni 70.

Të drejtat e Bankës, që kanë mbështetje të nji kambjali ose të nji kontrate, me dorëzanës ose pa dorëzanës, gëzojnë privilegjimin në shkallën e dytë, pas të drejtave privilegjueme të Shtetit.

Neni 71.

Dokumentat nga të cilat rrjedhin kreditë e Bankës Bujqësore, si: Hua, llogari rrjedhëse etj. . ., si dhe dorëzanít përkatëse, formojnë, titull ekzekutiv, dhe në rasë more e protestimi, Gjykatat, në dhomë këshilli, vendosin ekzekutimin mbi këto kredi edhe kuer dokumentat, nga të cilat rezultojnë, janë nënshkrue prej personave analfabetë e që figurojnë debitorë ose si dorëzanës.

Gjykatat vendosin ekzekutimin në themel të kopjeve të vërtetueme të dokumentave të tyne, nga të cilat rezulton krediti i Bankës.

Neni 72.

Banka, Sindikatat dhe Kooperativat e kredituemе prej sajë, mund të kërkojnë vendim ekzekutimi para skadencës s' afateve të kredive të tyne kuër disa prej pasunive të lujtëshme dhe të pa-lujtëshme të debitorit janë deklaruе për shitje publike. Në të këtilla rasa, Gjykata vendos mbrenda 3 (tre) ditëve ç' prej datës së kërkesës.

Neni 73.

Gjykatësit, Zyrat Përmbaruese ashtu edhe tagrambledhësit e Financës, detyrohen me i çue Qendrës së Bankës së Bujqësis dhe Kooperativës lokale nga nji shëmbëllorë të shpalljeve për të gjithë shitjet n' ankant publik të pasunive të lujtëshme dhe të pa-lujtëshme bujqësore.

Neni 74.

Banka ose degat e saja detyrohen me u dhanë gjithë Zyrave të Ipotekave, ku gjindet pasunija e debitorit, nji listë emnore të debitorve të sajë.

Zyrat e sipërtregueme, kur bajnë formalitetet për shit blemje të pasunive të pa-lujtëshme, detyrohen me kqyrë listat emnore të debitorve të Ban-

kës dhe, në rasë se konstatojnë që shitësi ndodhet debitori i sajë, nuk mund të kryejnë veprimet përkatëse pa u marrë mos-kundërshtimi i Bankës.

Noterët vërtetojnë ose autentikojnë aktet e shitjeve të pasunive të pa-lujtëshme, vetëm pasi të paraqitet çertifikata e Zyrës Ipotekore përkatëse.

Kuër debitori garanton për detën e tij mjaftësisht Bankën me të tjera pasuní, Banka detyrohet t' a ngrerë ndalimin.

VII. Llogarinat dhe Buxheti i Bankës

Neni 75.

Ministri i Ekonomís Kombëtare, kontrollon mbi veprimet e Këshillit Administrativ të Bankës Qendrore, gjithë veprimet e Drejtoris së Përgjithshme të Bankës Bujqësore dhe kujdesohet me vue në veprim pikërisht ligjët e rregulloret që i përkasin Bankës Bujqësore, Sindikatavet Bujqësore dhe Kooperativavet t' industrive Bujqësore.

Ministri i Ekonomís Kombëtare, këtë kontroll e ushtron me anë të nji delegati, shperblimi i të cilit caktohet në buxhetin e Bankës.

Neni 76.

Delegati i Ministris s' Ekonomís Kombëtare, ka tagër me marrë pjesë në mbledhjet e komitetit ek-

zekutiv si dhe në ato të Këshillit Administrativ të Bankës.

Delegati i përmendun, gjithmon lajmëron Ministrin e Ekonomís Kombëtare mbi gjithë çrregullimet dhe shkeljet e ligjës dhe të rregullores.

Neni 77.

Viti i ushtrimit të Bankës Bujqësore, fillon me 1 Kallnduer dhe mbaron me 31 Dhetuer.

Neni 78.

Këshilli Administrativ i Bankës i paraqet Ministris s'Ekonomis Kombëtare jo ma vonë se 1 Prill të çdo viti, bilançin vjetuer me veprimet e Bankës gjatë vitit të kaluem, bashkë me raportin e vet.

Bilançi duhet të përmbajë këto elementa:

NË PJESEN AKTIVE:

1) Të hollat e disponueshme:
   a) n' Arkë;
   b) pranë bankave.
2) Kredinat e akordueme:
   a) deri në 100 (njiqind) fr. ari;
   b) nga 100 njiqind) deri 500 (pesëqind) fr. ari
   c) nga 500 (pesqind) fr. ari e naltë.
3) Çmimi global i materialeve të disponueme (ndër depot);

4) Shpenzimet e instalimeve;
5) Çmimi global i pronave që i janë adjudikue Bankës;
6) Çdo llogari tjetër aktive që nuk mund të përfshihen në llogarít e sipër-tregueme.

NË PJESEN PASSIVE:

1) Kapitali:
   a) i rrjedhun prej burimeve të caktueme me ligjë:
   b) rezervë.
2) Detyrimet e ndryshme;
3) Depozitat:
   a) me afat:
   b) pa afat.
4) Çdo llogarí passive që nuk mund të hyjë në llogarín e sipërshënueme.
5) Humbje - fitime.

Shënim: Nji pasqyrë analitike e llogaris Humbje-fitime.

Bilanci në fjalë, me raportin e Këshillit Administrativ, së bashku edhe me nji raport të posaçem të Delegatit përmanent të Ministris s'Ekonomis Kombëtare, i parashtrohet nga ana e këtij Dikasteri nji Komisionit, i përbamë prej Kryetarit të Këshillit Kontrollues, i cili e kryeson, nji përfaqësuesi

të Ministris së Financavet dhe nji Antarit të Këshillit të Shtetit.

Ky Komision, passi të shqyrtojë bilancin bashkë me të dy raportat e sipërtregueme, redakton nji raportë, të cilën ja paraqet Ministrís s' Ekonomís Kombëtare. Kjo Ministrí, jo ma vonë se tre muej nga data e paraqitjes së raportit nga ana e Bankës shfaq mendimin e vet dhe, në rasë se bilançi aprovohet prej Ministrís, Këshilli Administrativ i Bankës ashtu edhe Komiteti Ekzekutiv shkarkohet nga përgjegjësija e veprimeve. Gjithashtu Këshilli Administrativ shkarkohet nga përgjegjësija, në qoftë se Ministrija e Ekonomís Kombëtare nuk çfaqë mendimin e sajë mbrenda afatit të sipërtreguem.

Neni 79.

Fitimet e thjeshta të Bankës Bujqësore ndahen si vijon :

a) 10 % për fondë rezervë ;

b) 20 % për me subvensionue sipërmarrëje zêjtare ose industrore bujqësore ;

c) 15 % për me ndihmue kooperativat e vogla të formueme për vleftësimin e bujqësís dhe industrive bujqësore ;

ç) 30 % për t' u shpërndá aksionistavet privat për me i u pague nji dividend që nuk mund të kalojë 10 %

d) 10 °/o si edhe diferenca që mund të rezultojë si mbas paragrafit ç) mbassi të ndahet fitimi mbi kapitalin privat, shtojnë kàpitalin e Bankës;

dh) 5 °/o për formimin e nji fondi të posaçëm për mbulimin e kredinave të pa - realizueshme;

e) 10 °/o për t' ju ndamë nëpunsave si shpërblim.

Neni 80.

Çdo dispozitë në kundërshtim me këtë ligjë mbetet pá fuqí.

Neni 81.

Për zbatimin e kësaj Ligje ka me u hartue Rregullorja e Posaçme, në të cilën do të shënohen normat edhe për emetimin e aksioneve që do t' u jepen privatëve, tue marrë për bazë 10 (dhetë) fr. ari nji aksion.

Neni 82.

Kryegjaja dhe çdo lloj pasuní, e lujtëshme ose e pa-lujtëshme e Bankës Bujqësore, me as nji mënyrë nuk mund të shkojë në Arkën e Shtetit ose të prishet për ndonji qëllim tjetër, përveç atyne që janë shprehun në këtë ligjë.

Neni 83.

Trupi Ministruer ngarkohet me zbatimin e kësaj Ligje.

Neni 84.

Kjo Ligjë hynë në fuqí nga dita e botimit të sajë në Fletoren Zyrtare.

ZOGU I.

MBreti i Shqiptarëvet

DEKRETON

Aprovimin dhe zbatimin e Ligjës mbi Bankën Bujqësore të Shqipnís, të votueme prej Parlamentit, si mbas shkresës Nr. 265 datë 23-XI-1936 të Kryesis së tij.

Tiranë, me 26 Nanduer 1936

ZOG d. v.

Kryeministri:
Zav. Ministri i P. të Jashtme
Zav. Ministri i Punëve Botore e
Zav. Ministri i Ek. Kombëtare:
K. Kotta d. v.

Ministri Drejtësis:
Th. Orolloga d. v.

Ministri i P. Mbrendëshme
Musa Juka d. v.

Ministri i Financavet
Kol Thaçi d. v.

Ministri i Arsimit
Faik Shatku d. v.

BKSH

BKSH